



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 1.10.2019

Dokument parlamentar

(Komisioni përgjegjës)

R A P O R T

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E KONTRATËS FINANCIARE, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE TË INVESTIMEVE, PËR PROJEKTIN “SHTRATI I LUMIT LANA – ZHVILLIM URBAN”

I. Hyrje

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 1.10.2019, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillim urban”, bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator Zj. Evis Kushi.

Për të mbrojtur projektligjin në emër të Qeverisë, ishin prezent Zj. Belinda Ikonimi, Zv/Minister, i Financave dhe Ekonomisë dhe Z. Arbjan Mazniku Zv. Kryetar i Bashkisë së Tiranës.

II. Baza kushtetuese e projektligjit

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83 pika 1 dhe nenit 121 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”.

III. Qëllimi i projektligjit.

Projektligji ka si qëllim ratifikimin e marrëveshjes, “Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillim urban”.

Kredia që akordohet nëpërmjet kësaj kontrate financiare është në shumën 8 milionë euro, me maturim për 20 vjet e me interes të përcaktueshëm mbi bazën e tregut në momentin e disbursimit.

Projekti përfshin zgjerimin e dy bulevardeve, të cilat janë paralele me lumin Lana, përkatësisht Bulevardet "Gjergj Fishta" dhe "Bajram Curri", deri te kryqëzimi me rrugën “Teodor Keko” dhe ka për qëllim zgjatimin e bulevardit nga Ura Teknologjike (ku përfundon aktualisht segmenti ekzistues) deri në kryqëzimin me rrugën “Teodor Keko” dhe rehabilitimin e shtratit të lumit të Lanës po për këtë segment. Kështu do të kontribuohet në rigjenerimin urban përmes pajisjes në zonën e lumit me infrastrukturë urbane (drenazhimi, kanalizimi, ndriçimi publik, autobusë dhe korsi të biçikletave) dhe përmirësimin e integritetit dhe lidhjes së dy brigjeve të lumenjve me Qytetin. Gjithashtu do të përfshijë punime pastrimi në shtratin e lumit Lana, rregullimin dhe ri-drejtimin e rrjedhës së lumit për të shmangur problemet e përmytjeve në këtë zonë.

Nëpërmjet këtij projekti mundësohet krijimi i një shtrati me regjim hidraulik eficient, për të eliminuar problematikën e përmytjeve në këtë zonë, si dhe krijimin e hapësirave të nevojshme të zhvillimit urban të zonës. Tubat e kanalizimeve që do të vendosen si pjesë e punimeve do të lidhen me rrjetin e kanalizimit, i cili aktualisht është duke u përmirësuar si pjesë e Projektit të Përmirësimit të Kanalizimit të Tiranës së Madhe. Paralelisht dhe si pjesë e këtij Projekti të Kanalizimeve, Autoriteti Kombëtar i Ujit (AKUK) po udhëheq ndërtimin e impiantit të parë të trajtimit të ujit në rrethin e Kasharit, që pritet të përfundojë deri në fund të vitit 2022.

IV. Efektet financiare

Sipas kontratës financiare, përcaktohet se:

- Maturimi i kontratës do të jetë 20 vjet, duke përfshirë një periudhë pa pagesë principali prej 4 vjetësh;
- Interes do të përcaktohet mbi bazën e tregut në momentin e disbursimit.

Ndërkohë vlera që do të mbulohet nga Fondet e buxhetit të Bashkisë Tiranë në vlerën 13.37 milion euro, do të jetë të shpërndara në 3 vite buxhetore duke nisur që nga viti buxhetor aktual.

V. Shqyrtimi i projektligjit në komision.

Relatori i Komisionit, dha një informacion përmbljedhës mbi kontratën financiare, përshkrim të projektit, vlerës totale të tij dhe mënyrën e financimit të plotë të tij duke evidentuar si vijon:

Kredia që akordohet nëpërmjet kësaj kontrate financiare është në shumën 8 milionë euro dhe është pjesë e bashkëfinancimit të projektit “Shtrati i lumit Lana – zhvillim urban”. Kontrata financiare është miratuar, në parim, me vendimin nr.404, datë 19.6.2019, nga Këshilli i Ministrave, dhe është nënshkruar ndërmjet palëve.

Kostoja totale e projektit, siç vlerësohet nga Banka Europiane e Investimeve, është 23,770,000 Euro shumë që do të financohet si më poshtë:

- Kredi nga Banka Europiane e Investimeve 8 milion euro;
- Granti i dhënë po nga Banka Europiane e Investimeve në shumën 2.4 milion euro; si dhe,
- Fondet e buxhetit të Bashkisë të cilat do të jenë në shumën 13.37 milion euro.

Kredia e akorduar përmes kësaj kontrate financiare, ka për qëllim mundësimin e realizimit të projektit “Shtrati i lumit Lana - Projekti i Zhvillimit Urban projekt ky që, përfshin vepra rreth 1.8 km të lumit Lana dhe përfundon rehabilitimin e lumit të bërë përgjatë përafërsisht 16 km në rrjedhën e sipërme të zonës së Projektit në Bashkinë e Tiranës. Zona që ndikohet nga projekti shtrihet në një sipërfaqe prej 110 ha dhe në të janë parashikuar 2 ura mbi shtratin e ri të lumit për nevojat e zhvillimit urban.

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Bashkia e Tiranës dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Projekti do të ndërtohet gjatë periudhës 2019-2022.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, bënë një prezantim të termave dhe kushteve financiarë të kontratës së financimit si dhe argumentuan përfitimet dhe avantazhet e shtuara të këtij projekti. Gjithashtu iu përgjigjën edhe pyetjeve të deputetëve lidhur me impaktin social të projektit dhe masat që do të ndërmerren lidhur me shpronësimet e nevojshme për qëllime të realizimit të projektit.

Përfaqësuesit e opozitës gjatë shqyrtimit të projektligjit, ngritën shqetësimin lidhur me mungesën e projektit të detajuar, mungesë kjo e cila ngre pikëpyetje lidhur me mënyrën e përlogaritjes së fondeve të nevojshme për realizimin e projektit.

Për sa më sipër, përfaqësuesi i Bashkisë së Tiranës, dhe një shpjegim të plotë mbi veprimet paraprake të ndërmarra nga Bashkia e Tiranës, me qëllim mundësimin e realizimit të projektit dhe të sigurimit të financimit të tij.

Komisioni u informua se, puna për realizimin e këtij projekti ka filluar rreth 3 vite më parë dhe për këtë qëllim janë kryer të gjitha studimet dhe kanë përfunduar projektet e nevojshme për realizimin e projektit “Shtrati i lumit Lana – zhvillim urban”, ku si të tilla u evidentuan, studimi zhvillimor, ambiental, madje edhe projekti i detajuar për zbatimin e projektit.

Të gjithë këto studime dhe projekte janë bërë pjesë e dosjes për fillimin e negociatave me Bankën e Evropiane të Investimeve dhe kanë shërbyer për konkludimin e kësaj marrëveshje financiare dhe marrëveshjes së grantit. Gjithashtu Banka e Evropiane e Investimeve, duke parë angazhimin e Bashkisë së Tiranës dhe përfitimet e shumta që sjell ky projekt, ka mundësuar edhe një grand tjetër me përfitues direkt Bashkinë e Tiranës, grand ky që mundëson realizimin e plotë të projektit. Gjithashtu Bashkia e Tiranës ka marrë masat edhe për shpronësimin e banesave të cilat preken nga ky projekt.

Anëtarët e tjerë të komisionit, e vlerësuan këtë projekt tejet të rëndësishëm për popullsinë e Tiranës e cila në vazhdimësi ka vuajtur pasojat e përmytjeve prej lumit Lana. Ky projekt do të sjelli stabilitet tek banorët do të ketë impak në infrastrukturë dhe do të rrisi vlerën e banesave të qytetarëve.

Gjithashtu, anëtarët e komisionit i kërkuar Bashkisë së Tiranës që të mundësojë takime dhe komunikim të vazhdueshëm, me banorët e zonës të cilët do të shpronësohen në kuadër të këtij projekti, për t’iu shpjeguar dhe informuar lidhur me efektet e projektit, procedurat që do të ndiqen për shpronësim, formën dhe masën e shpronësimit etj. Kësisoj do të mund të shmangen fenomenet e padëshirueshme që aktualisht kemi hasur në zonën e ashtuquajtur “Astir”. Për këtë qëllim, për të mundësuar shmangien e fenomeneve të kësaj natyre, iu kërkuar Bashkisë së Tiranës, rivlerësimi i kujdesshëm i çdo mundësie për të shmangur aty ku është e mundur por sigurisht pa cenuar projektin, shpronësimin e banesave të qytetarëve.

Në përfundim të mbledhjes, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, shqyrtoi edhe raportet e komisioneve të tjera që e kanë shqyrtuar projektligjin në cilësinë e komisioneve për dhënie mendimi, nga ku rezultoi se e ato e kanë gjetur marrëveshjen të mbështetur në Kushtetutë dhe në legjislacionin në fuqi dhe e kanë miratuar atë.

VI. *Përfundime.*

Në përfundim, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, duke evidentuar faktin se kjo marrëveshje është në përputhje me Kushtetutën si dhe legjislacionin në fuqi për marrëveshjet ndërkombëtare si dhe duke vlerësuar se ky projekt do të ndikojë pozitivisht në zhvillimin e zonave përkatëse, duke siguruar një infrastrukturë të qëndrueshme, që do t'i shërbejë edhe zonave përreth saj, me votat pro të të gjithë anëtarëve të pranishëm, e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi.

RELATOR

KRYETAR

Evis KUSHI

Arben AHMETAJ